



## PROGESVERBAL VII/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së VII (shtatë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 12.07.2024  
**Ora :** 10:00

---

### **Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
*z. Urim Suka*  
*znj. Bulëza Kuçi*  
*znj. Sanie Kuçi Rexhepaj*  
*znj. Fidaije Kukaj*  
*z. Dardan Berisha*  
*z. Liridon Fandaj*

### **Të pranishëm tjerë:**

**Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj**  
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 3. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2024;**
- 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2023;**
- 5. Informatë për aktivitetet e KKS-së për periudhën Janar-Qershor 2024;**
- 6. Raporti nga DSHPJK për periudhën janar-qershor 2024 për çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim;**

**Kryesuesi** - i njofton të pranishmit se ka dhe një pikë shtesë në rend dite e cila ka të bëjë me planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2023. E hedh në votim pikën shtesë.

**4 për,1 apstenim.Miratohet pika shtesë**

**Urim Suka** - duke marrë shkas nga krekosja e fundit me postimet e juaja që raporti i auditimit është pozitiv,unë propozoj si pikë shtesë të rendit të ditës që ne si kuvend ta miratojmë një komision i cili do t'i shqyrtonte të gjitha investimet për vitin 2023 që janë bërë nga komuna e Suharekës dhe do të dilte me një konkluzion konkret se si kanë shku këto investime.A kanë shku siç po thotë raporti i auditimit apo ka shkelje të cilat ne pretendojmë që ka shkelje gjatë implementimit të projekteve.

**Kryesuesi** - e hedh në votim propozimin e Urimit për rend dite.

**3 për,3 kundër**

**Në këtë rast Kryesuesi e përdor votën e dyfisht dhe voton kundër.**

**Nuk miratohet propozimi**

**Kryesuesi** - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

**4 për,2 apstenime.Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë.**

**Pika 1.**

**Urim Suka** - është një gabim teknik te rendi i ditës ku dikun shkruan komuna e Sharrës.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Liridon Fandaj** - te pronat që kemi marrë vendimet më herët, muk kam pa ndonjë shpallje që kanë dalë për konkurim. Pse janë këto vonesa?

**Avni Bytyqi** - janë tri procedura në proces. Për dy procedura është duke i udhëheq Drejtori i Urbanizmit dhe një tjetër që është në procedurë, ende nuk është kthyer vlerësimi i ligjshmërisë.

**Liridon Fandaj** - për deri sa vje një kërkesë për dhënie në shfrytëzim të pronës, bëhet vendimi dhe kalon edhe komisioni por ato nuk shpallen, cila është arsyeja e vonësës?

**Avni Bytyqi** - aktualisht ligji që është në fuqi dhe rregullorja nuk e ka të rregulluar këtë çështje dhe është në mëshirën e komisionit se kur i fillon procedurën. Zyrtyari ligjor tutje jep sqarime.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 2

**Unanimisht Miratohet pika 2**

**Pika 3. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2024;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - vazhdimisht kur po na vin këto raporte unë e kam ngrit shqetësimin për vonesat në shpenzimin e buxhetit, që mjetet po shpenzohen në tre mujorin e fundit. E njëjta praktikë vazhdon edhe në këtë 6 mujor që na ka ardhë. Në bazë të kësaj që na keni sjell rezulton që 9.7 % është shpenzu buxheti. Shpenzimi i vetëm 9 % të buxhetit për 6 muaj mendoj që është praktikë jo e mirë. Për mua kjo çështje është shqetësim që duhet me pas fokus si qeverisje, me shpenzu nëpër muaj të caktuar buxhetin pak më racional dhe jo me koncentrua gjithë buxhetin në tre muajt e fundit.

**Bulëza Kuçi** - unë pajtohem me ato që tha Urimi. Drejtorat nuk janë këtu për me i pyet pak më në detaje. P.sh .shpenzimet elektronike më duken pak shumë. Përveq Drejtorit të Arsimit që e ka një shumë pak më të vogël, të tjerët afërsisht 200€ e më shumë për shërbime telefonike. Kodi për shpenzime të anëtarësimit nuk e kam të qartë, kush hyn këtu?

**Kryesuesi** - çdo komunë është e anëtarësinë në asociacionin e komunave dhe paguajnë një shumë.

**Bulëza Kuçi** - te interneti, interneti për zyra apo për çka?

**Kryesuesi** - nuk bën pa pas internet në zyre. E hedh në votim pikën 3.

**Unanimisht Miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Suharekës për vitin 2023;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - unë e di që raporti i auditorit është i pavarur dhe unë deshtë apo s' dashka e pranojmë si raport edhe pse gjendja në teren është krejtësisht e kundërta nga ajo që thotë raporti edhe pse raporti ka plot gjetje që edhe ne i kemi përmend, siç është mungesa e projekteve ekzekutive etj. Opinioni përfundimtar është i pamodifikuar dhe ju jeni krekosur për këtë pjesë. Ajo që më shqetëson mua më së shumti është fakti që përtej kësaj që u tha, unë duke mos dashtë me hedhë poshtë raportin e auditorit dhe me që ju po thoni që gjendja është mirë, unë e kërkova edhe si pikë shtesë të rendit të ditës që ta formojmë një komision prej krejt partive dhe këtë gjendjen e mirë ta pasqyrojmë si asamblistë. Vullneti për mos me formu këtë komision po më le me dyshu që edhe ju e dini që gjatë rrugës ka shumë shkelje dhe kjo më shqetëson. Edhe ky raport që ju po pretendoni që është i mirë, e thotë që disa prej gjetjeve janë përsëritje të viteve të kaluara. Ne do ti japim përkrahje që ky raport me shku në Kuvend dhe ne si LDK do të

përpiqemi që gjetjet e auditorit ti adresojmë në kuvend por edhe gjetjete tona si dhe kërkesën për me pas një komision me të vetmin qëllim që të përmirësohemi por nuk do të thotë që e mbështesim raportin.

**Liridon Fandaj** - fakti që ai që e ka pranuar raportin nuk është këtu, ne mund të diskutojmë por s' mundemi me i thanë ato çka duhet me i thënë atij sepse ai është kërenu me atë që raporti ka dal shumë mirë. Në mes të këtyre të gjeturave janë 10 rekomandime ku 7 prej tyre veq janë rekomandime të përsëritura. Pasi drejtori i Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtari i tyre e që keqklasifikimet janë të asaj zyre, nuk janë këtu, unë këto do ti ngris në Asamble por Kryetari duhet me qenë më i përgjegjshëm sepse është një prej raporteve më kryesore që e shpalos punën e tij të mirë ose të keqe.

**Dardan Berisha** - Sa i përket propozimit të formimit të komisionit nuk është hera e parë që propozohet me u formu një komision që ne duhet me dal mbi institucione. Ne nuk duhet me formu një komision brenda asamblesë që me dal mbi auditorin. Ndoshta Urimi e ka mirë por mua nuk më duket që e ka mirë dhe për atë arsye vota ime ishte kundër. Sa i përket raportit të auditorit është mirë me qenë drejtori prezent edhe i gjithë sektori përkatës i buxhetit por sido çoftë ne e përcjellim për Asamble.

**Kryesuesi** - është e vërtetë që në bazë të raportit që është dhënë si i pamodifikuar dhe i kanë dhënë 10 rekomandime, në vitin 2022 kanë qenë 17 rekomandime. Sa i përket komisionit mendoj që është e pakuptimtë me dal ne dhe me dhënë një vlerësim për auditorin.

**Urim Suka** - po pretendoj që ju jeni duke keqinterpretu me qëllim. Auditori punën e vet dhe ne punën tonë. Unë kam bindjen që buxheti është shpenzu keq. Ju po thoni që raporti ka dal mirë dhe gjendja është mirë. Për me e kry këtë diskutim unë po e kërkoj formimin e komisionit.

**Dardan Berisha** - ky komision kujt do ti referohet?

**Urim Suka** - investimeve.

**Dardan Berisha** - për investime ke kërku edhe më herët por nuk i ke marrë votat.

**Liridon Fandaj** - Urimi nuk e ka kërku një komision që e ka kërku edhe herave tjera por po e kërkon për investime kapitale dhe raporti i auditorit nuk i ka krejt investimet kapitale. Unë nuk them që e ka mirë Urimi por edhe keq nuk e ka sepse gjendja në teren nuk është e mirë.

**Dardan Berisha** - ne jemi asambleista dhe e kemi obligim me dal çdo sekond dhe çështjet po i ngritim edhe në asamble dhe edhe ne jemi një lloj auditori.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

## Unanimisht Miratohet

### Pika 5. Informatë për aktivitetet e KKSB-së për periudhën Janar-Qershor 2024;

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Dardan Berisha** - te çështja e festës që ka ndodh në sheshin e Suharekës, kjo ka qenë tema kryesore që është dasht të diskutohet në KKSB prej Drejtorit të Arsimit. Për mua është shumë shqetësuese dhe për mendimin tim ka qenë aheng tipik politik dhe Drejtori i Arsimit thotë që nuk ka të bëj me mua. Ka pas edhe dukuri negative.

**Urim Suka** - pajtohem me shqetësimin që e ngriti Dardani. Ajo që mua më shqetëson është që të paktën ajo që ka ndodh të ishte pasqyrë edhe në KKSB. Zanafillën e këtij organizimi krejt e dimë. Nëse ky organizim është kërkesë i këshillit të nxënësve, është kërkesë e profesorëve, është kërkesë e prindërve dhe janë në letër, ok. i japim përkrahje. Ndoshta është mirë dikush nga personat përgjegjës me na raportu në Kuvend, përveq raportit që është në letër në përgjithësi me na fol për gjendjen e sigurisë e pastaj ne me diskutua. Seancën e kaluar unë e kam kërkuar një lloj raporti që të dihet çka ka ndodh me atë organizim, sa ka kushtar dhe kush e ka pagu sepse atë ditë Drejtori i DKA-së u tërhek prej përgjegjësisë për shkak se e dinë që e ka bërë dikush tjetër. Si raport le të shkon për Asamble.

**Dardan Berisha** - ne e dimë që s' mund të merren vendime por si do që të jetë është mirë një raport prej policisë.

**Avni Bytyqi** - i keni dy mundësi. Mundësia e parë është ti rekomandoni KKSB-së që të diskutohet kjo çështje në KKSB dhe ata me dal me rekomandim dhe mundësia e dytë është që ju të kërkonit pikë shtesë në rend dite në Kuvend për diskutim. KKSB-ja vepron në bazë të një plani të veprimit që është miratua

nga Kuvendi dhe ne i diskutojmë pikat që janë miratua në kuvend dhe pikat që rastisin aty për aty për me i diskutua.

**Liridon Fandaj** - në bazë të këtyre që janë në raport, shumica janë publike por unë nuk e shoh ndonjëherë ndonjë pikë që vërtetë është shqetësuese për qytetarët ose për shkollat. A duhet gjithmonë me rekomandua dikush apo ata anëtar që janë aty me marrë si shqetësim. Unë mendoj që ai organizim duhet të hetohet sepse aty u përdor substancë narkotike,alkool dhe ka edhe video.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**5 për,1 abstenim. Miratohet Pika 5**

**Pika 6. Raporti nga DSHPJK për periudhën janar-qershor 2024 për çështjen e dhënies së pronave në shfrytëzim;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - dua ta falënderoj publikisht Drejtorin e Pronës për korrektësinë sepse nuk ka seancë të KPF-së që nuk është i pranishëm dhe edhe në komunikime direkte e indirekte qoftë në Asamble është një prej drejtorëve më të përgjegjshëm të kësaj qeverisje. Raportin e analizojmë dhe e diskutojmë në Asamble.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 6.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 7. Shqyrtimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit nga zyra kombëtare e auditimit për vitin 2023;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 7 shtesë.

**4 për,2 abstenime. Miratohet pika 7**

Takimi përfundoi: **10:50**

Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj